



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr.63/ 2011**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Rafet Haxhaj dhe Hasan Shala, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 13.01.2011, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)

### A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 10.01.2011, nga LDK-ja në të cilën theksohet se “në QV 2107B/03R vëzhguesi i LDK-se ka vërejtur parregullsi të mëdha, pasi vëzhguesit e PDK-se kanë poseduar kopje të librit të votuesve dhe kanë bërë verifikimin e votuesve sikurse kryesuesi. Mungesa e rrymës në korridor të qendrës në orët e mbrëmjes po ashtu ka rezultuar me parregullsi, ku një person ka votuar për dy persona. Parashtruesi i ankese ka bashkangjitur si dëshmi deklaratën e vëzhguesit të LDK-ës Bajram Abdullahu.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh si vijon:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

**- ankesa është e pabazuar.**

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës janë të pabazuara për shkakun nuk janë ofruar prova të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur shkelja e pretenduar. Për më tepër parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar asnjë të dhënë mbi identitetin e vëzhguesve të cilët kanë poseduar librin e votimit si dhe personin i cili ka votuar për dy persona të tjerë. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuara më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 63/2011 më datën 13.01.2011.

Kryesuesi i Panelit  
Ferit Osmani

